

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8333
E enjte, 2 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

Fillojnë patrullimet e përbashkëta policore Kosovë - Shqipëri



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSARI-LILA: MOSPAJTIMET BRENDA PARTIVE MUND TA VËSHTIRËSOJNË KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

FAÇE 4-5



Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka theksuar të mërkurën se, pas certifikimit të rezultateve, pritet të nisë komunikimi zyrtar

ndërmjet partive për krijimin e institucioneve të reja. Sipas saj, mospajtimet dhe qëndrimet e ndryshme brenda partive mund ta vështirësojnë konstituimin e institucioneve

dhe arritjen e një dakordimi ndërmjet subjektit fitues të zgjedhjeve dhe partive të tjera, ndërsa ka theksuar se projektet strategjike nuk duhet të përdoren për përplasje politike

PRATTIPATI: QËNDROJMË ME KOSOVËN NË PËRPPJEKJET E SAJ PËR TË NDËRTUAR INSTITUCIONE TË FORTA

F. 3



BE-ja KËRKON PËRSHPEJTIMIN E REFORMAVE NË KOSOVË NË TAKIMIN E KOMITETIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT

F. 7



AKTUALE



BE-ja VENDOS TARIFA PËR BLERJE NGA TEMU, ALIEXPRESS E KOMPANI TË TJERA KINEZE

F. 2

GJYKATA SHOIPTON DËBIM, NDALIM HYRJEJE NË KOSOVË DHE GJOBA PËR TË NDALUARIT NË GAZIMESTAN

F. 6

SENATI I UP-së MIRATON VENDIME STRATEGJIKE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK, PROGRAMET E REJA TË STUDIMIT DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

F. 7

EKONOMI



PAGA MINIMALE NË KOSOVË RRRITET NË 500 EURO

F. 8

AKB-ja: RRRITJA E PAGËS MINIMALE DUHET TË BAZOHET NË LIGJ, E PADREJTË QË U PËRJASHTUAN VETERANËT E UÇK-së

F. 8

SPORT



ADEMI URON KLUBET E PROMOVUARA NË KATEGORITË MË TË LARTA TË FUTBOLLIT TË KOSOVËS

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vance: SHBA-ja kërkon që Irani të bëjë lëshime domethënëse

UASHINGTON, 1 KORRIK - Nënpresidenti amerikan, JD Vance, tha se Uashingtoni do ta gjykojë Teheranin nga sjelljet e jo nga retorika e tij, duke theksuar se qëllimi i negociatave është të përcaktohet nëse Irani është i gatshëm të bëjë lëshime domethënëse. "Një pjesë e asaj

që po përpqemi të bëjmë në këto negociata është të shohim se sa seriozë janë në të vërtetë", tha Vance për Fox News. "Për të qenë seriozë, nuk mjafton vetëm që të thonë gjërat e duhura. Ata duhet të bëjnë lëshime të vërteta". "Nuk na intereson shumë ajo që thonë iranianët. Na intereson më

shumë ajo që bëjnë", tha ai. "Ajo që kam mësuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara është se, qoftë mik apo kundërshtar, nuk duhet t'i besosh askujt, duhet t'u besosh veprimeve të njerëzve". "Nëse veprojnë siç duhet, nëse sillen siç duhet, atëherë do të përfitojnë shumë", shtoi nënpresidenti amerikan.

Vance tha se administrata amerikane po sheh sinjale edhe pozitive edhe negative nga Irani dhe do të vazhdojë të ndjekë drejtimin e presidentit Donald Trump, në negociata. Ai shtoi se edhe nëse diplomacia dështon, Uashingtoni beson se veçse ka arritur objektivin e tij përësor.



BE-ja VENDOS TARIFA PËR BLERJE NGA TEMU, ALIEXPRESS E KOMPANI TË TJERA KINEZE

BRUKSEL, 1 KORRIK - Bashkimi Evropian ka hequr përjashtimin doganor që lejonte që dërgesat e vogla nga vendet e treta të hynin në bllok pa paguar doganë. Kjo do të thotë se konsumatorët evropianë nuk do të mund të blejnë më mallra përmes platformave të njohura kineze si Shein, Temu dhe AliExpress me kushtet e deritanishme, për shkak të të cilave, produktet e tyre shpesh ishin dukshëm më të lira se mallrat e prodhuara në Bashkimin Evropian.

Nga 1 korriku, blerjet online jashtë BE-së me vlerë deri në 150 euro nuk janë më të përjashtuara nga dogana, ka njoftuar Komisioni Evropian (KE).

Bëhet fjalë për rregulla që kanë për qëllim krijimin e kushteve më të barabarta për kompanitë e BE-së dhe forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se ky ndryshim synon të krijojë kushte më të drejta për kompanitë evropiane dhe të sigurojë mbrojtje më të mirë për konsumatorët. "Shumë prej këtyre produkteve nuk i përmbushin standardet e sigurisë së BE-së, duke i ekspozuar konsumatorët ndaj rrezikut", shkroi ajo në X.

Sipas njoftimit të KE-së, mallrat e blera online nga vendet e treta dhe që dërgohen drejtpërdrejt te konsumatorët tani i nënshtrohen një tarife doganore prej 3 eurosh për çdo kategori produkti.

Këtë tarifë formalisht do ta paguajnë platformat online ose



kompanitë që shesin dhe importojnë mallrat. Megjithatë, Komisioni Evropian pranoi se nuk mund të parashikohet nëse kjo kosto shtesë do t'u bartet konsumatorëve përmes çmimeve më të larta të produkteve. "Janë konsumatorët ata që nuk duhet ta paguajnë këtë tarifë, por shitësit ose platformat online që tani janë të detyruara të paguajnë tarifën doganore. Natyrisht, ne nuk mund të flasim në emër të shitësve apo platformave se a do t'i rrisin çmimet, por përgjegjësia për pagesën e tarifës prej 3 eurosh nuk është te konsumatorët", tha zëdhënësjja e Komisionit Evropian, Arianna Podesta.

Tarifa nuk llogaritet për paketë, por sipas llojit të produktit. Kjo do të thotë se blerja e një artikulli në disa copë ose madhësi - për shembull pesë bluza të njëjta me numra të ndryshëm - do të tarifohet me një taksë të vetme prej 3 eurosh. Megjithatë, nëse në të njëjtën dërgesë blihen lloje të ndryshme produktesh, për

shembull një bluzë, një orë dhe një lodër, për secilën kategori produkti do të llogaritet një taksë e veçantë prej 3 eurosh, edhe pse të gjithë artikujt vijnë në një paketë të vetme. "Ky përjashtim ishte futur për të shmangur kostot e larta administrative për blerjet me vlera të vogla. Megjithatë, rrethanat sot janë krejtësisht të ndryshme. Tani në Bashkimin Evropian çdo ditë mbërrinjë miliona pako me vlera të vogla", tha Podesta. "Në të njëjtën kohë, kompanitë e BE-së që importojnë mallra me shumicë paguajnë detyrime doganore, ndërsa platformat e mëdha online nga vendet e treta mund t'i dërgojnë mallrat direkt te konsumatorët pa këto kosto. Kjo ka prishur konkurrencën e barabartë në treg, ndërsa heqja e përjashtimit mundëson krijimin e kushteve të barabarta për bizneset evropiane", shtoi ajo.

Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, vetëm gjatë vitit 2025 në tregun e BE-së kanë

mbërritur 5.9 miliardë artikuj në pako me vlera të vogla nga vendet e treta, pa paguar doganë.

Kjo do të thotë se përmes doganave evropiane çdo ditë kalojnë më shumë se 16 milionë pako të destinuara për konsumatorët. Paketat me vlera të ulëta sot përbëjnë 97 për qind të të gjitha artikujve të importuar në BE, por vetëm 2 për qind të vlerës totale të importeve. "Me ndryshimin e modeleve tregtare, konkurrenca në këtë sektor nuk është më e barabartë. Rregulli i përjashtimit është keqpërdorur në mënyrë rutinore përmes nënvlerësimit të mallit ose ndarjes artificiale të porosive në disa pako për të qëndruar nën pragun prej 150 eurosh", thuhet në njoftimin e KE-së.

Brukseli thotë se rregullat e reja do të barazojnë kushtet e biznesit mes tregtarëve evropianë që importojnë mallra me shumicë dhe platformave të mëdha online jashtë BE-së.

Në të njëjtën kohë, pritet që ato të kontribuojnë edhe në zgjidhjen e problemeve mjedisore të lidhura me rritjen e shpejtë të tregtisë elektronike, përfshirë shtimin e mbetjeve nga paketimet dhe emetimet që krijohen gjatë transportit.

Sistemi i ri do të përfshijë edhe identifikues produktesh (PID) për mallrat e importuara, të cilët do t'u mundësojnë autoriteteve doganore zbulim më të lehtë të produkteve të pasigurta dhe mallrave që nuk janë në përputhje me standardet e BE-së. Përdorimi i tyre do të jetë vullnetar nga 1

korriku 2026, ndërsa i detyrueshëm nga nëntori i po këtij viti.

Komisioni Evropian thotë se një hulumtim i kryer gjatë vitit 2025 ka treguar se më shumë se 60 për qind e mallrave me vlerë të ulët që hyjnë në BE nuk përputhen me standardet evropiane të sigurisë ose me rregullat e cilësisë së produkteve, gjë që ngre shqetësime për praninë e substancave toksike dhe etiketimin e pasaktë. Sipas rregullave të reja, platformat online do të kenë statusin e të ashtuquajturit "importues i supozuar", duke u bërë ligjrisht përgjegjëse për sigurinë e produkteve dhe mund të ndëshkohen nëse mallrat nuk i përmbushin standardet e BE-së.

Tarifa doganore prej 3 eurosh është një masë e përkohshme dhe do të zbatohet deri në korrik 2028, kur pritet të bëhet funksionale Qendra e re Doganore e të Dhënave e Bashkimit Evropian. Pas kësaj do të zbatohen tarifatat standarde, në varësi të klasifikimit tarifor, origjinës dhe vlerës së produktit. Kjo masë është pjesë e një reforme më të gjerë të sistemit doganor të BE-së, e cila është miratuar nga Parlamenti Evropian dhe shtetet anëtare në mars 2026. Reforma parashikon gjithashtu vendosjen e një tarife të veçantë për përpunimin e dërgesave nga tregtia elektronike nga nëntori 2026, me qëllim që t'u ndihmohet shërbimeve doganore të mbulojnë kostot e rritura nga numri gjithnjë e më i madh i pakove.

Franca cakton datën e zgjedhjeve presidenciale, raundi i parë më 18 prill 2027

PARIS, 1 KORRIK - Franca do të zhvillojë zgjedhjet e ardhshme presidenciale më 18 prill dhe 2 maj 2027, sipas një burimi qeveritar që konfirmoi për AFP-në vendimin, i cili pritet të zyrtarizohet në mbledhjen e ardhshme të kabinetit

qeveritar.

Sipas të njëjtit burim, qeveria zgjodhi këtë kalendar në vend të alternativës që parashikonte mbajtjen e zgjedhjeve më 11 dhe 25 prill 2027.

Sipas Kushtetutës franceze, zgjedhjet presidenciale duhet

të zhvillohen nga 20 deri në 35 ditë përpara përfundimit të mandatit të presidentit në detyrë.

Presidenti Emmanuel Macron nisi mandatin e tij të dytë më 14 maj 2022 dhe, sipas kufizimeve kushtetuese, nuk mund të

kandidojë për një mandat të tretë radhazi.

Raundi i parë i zgjedhjeve do të mbahet gjatë pushimeve pranverore të shkollave, ndërsa raundi i dytë është planifikuar për më 2 maj 2027, një ditë pas festës së 1 majit.



VIHET NË PIKËPYETJE SAMITI I NATO-S NË SHQIPËRI

TIRANË, 1 KORRIK - Teksa udhëheqësit e NATO-s po përgatiten për samitin në Turqi, që mbahet javën e ardhshme, planet e aleancës për samitin në Shqipëri vitin e ardhshëm janë vënë në pikëpyetje.

Radio Evropa e Lirë ka konfirmuar nga burimet se Tirana nuk përmendet në draft-deklaratën për samitin e NATO-s - që mbahet në Ankara javën e ardhshme - si vend ku do të mbahet samiti i radhës.

Ndërkaq, agjencia Reuters, duke u thirrur në burime, tha se mbajtja e samitit në Tiranë është vënë në pikëpyetje për shkak të rezistencës nga administrata amerikane dhe pakënaqësia në mesin e shteteve aleate me shpenzimet e ulëta për mbrojtje nga Shqipëria.

Mospërmendja e Shqipërisë në draft-deklaratën vjen teksa anëtarët evropianë të NATO-s synojnë t'i dëshmojnë presidentit amerikan, Donald Trump, në Ankara se kanë bërë përparim sa i përket zotimeve për shpenzimet për mbrojtjen dhe synojnë të shmangin një përplasje të drejtpërdrejtë me udhëheqësin amerikan.

Një nga burimet e Reutersit tha se shpenzimet për mbrojtje të Shqipëri janë të tilla sa po të mbahej samiti i NATO-s në këtë shtet më 2027, Trump mund të zemërohet.

Një diplomat evropian tha se versioni i fundit i tekstit të

deklaratës thekson se udhëheqësit mezi presin takimin e tyre të radhës, pa specifikuar kohën dhe vendin ku do të mbahet ky takim. "Draftet janë drafte, jo vendime", tha një zëdhënës i Qeverisë shqiptare për Reuters kur u pyet për draft-deklaratën, për të cilën ende po negociohet dhe mund të pësojë ndryshime. Shtëpia e Bardhë nuk deshi të komentonte, ndërkaq një zyrtar i NATO-s tha se nuk do të komentojnë për këtë çështje tani.

Në vitet e fundit, deklaratat zyrtare të samiteve të NATO-s kanë pasur referencë të qartë për vendin e samitit pasues. Në samitin në Hagë të mbajtur vitin e kaluar, udhëheqësit thanë në deklaratën e tyre se "mezi presim të takohemi në Turqi më 2026 dhe më pas në Shqipëri".

Në të njëjtin samit, udhëheqësit e NATO-s iu përgjigjën kërkesës së Trumpit që të zotohen për 5 për qind të Bruto Prodhimit të Brendshëm në shpenzime të mbrojtjes brenda një dekade.

Shtetet kanë premtuar se do të shpenzojnë 3.5 për qind të Bruto Prodhimit të Brendshëm për çështjet bazë të mbrojtjes - si trupat dhe armët - ndërkaq 1.5 për qind në masa të tjera të lidhura me mbrojtjen, sikurse siguria kibernetike.

Derisa shumë shtete të NATO-s kanë rritur buxhetet e tyre për mbrojtjen në muajt e fundit,



disa shtete ende nuk e kanë përmbushur qëllimin paraprak të shpenzimeve për këtë fushë deri në 2 për qind.

Shefi i NATO-s, Mark Rutte, tha më herët gjatë këtij muaji se pothuajse të gjitha shtetet e aleancës e kanë arritur synimin prej 2 për qind. "Vitin e kaluar, Shqipëria, Çekia, Sllovenia nuk e arritën këtë, por janë të përkushtuara që shpenzimet t'i rrisin mbi 2 për qind këtë vit", tha ai.

Qeveria e Shqipërisë tha në një deklaratë për Reutersin se po

"finalizojmë masat e nevojshme fiskale për të harmonizuar shpenzimet e Shqipërisë për mbrojtjen dhe ato të lidhura me mbrojtjen për vitin 2026 në bazë të trajektoreve së dakorduar me aleatët e NATO-s në samitin e Hagës".

"Sapo këto masa të miratohen në ditët në vijim, shpenzimet e Shqipërisë për mbrojtjen dhe ato të lidhura me mbrojtjen për vitin 2026 do të arrijnë në 2.6 për qind të Bruto Prodhimit të Brendshëm në përpjethje me Metodologjinë e NATO-s për

Shpenzimet e Mbrojtjes. Prej tyre, 2.2 për qind e BPB-së përfaqëson shpenzimet bazë për mbrojtjen, ndërsa 0.4 për qind përfaqëson shpenzime të tjera që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë", u tha në deklaratë.

Një diplomat evropian tha se Shqipëria ende mund të jetë mikpritëse e samitit. "Ata po i rrisin shpenzimet, të shohim se çfarë do të prodhojë kjo", tha diplomati, duke shtuar se "unë ende besoj se samiti i radhës do të jetë në Shqipëri".

PRATTIPATI: QËNDROJMË ME KOSOVËN NË PËRPPJEKJET E SAJ PËR TË NDËRTUAR INSTITUCIONE TË FORTA

PRISHTINË, 1 KORRIK - E ngarkuara me punë në Ambasadën amerikane, Anu Prattipati, tha se teksa Kosova vazhdon të integrohet në komunitetin ndërkombëtar, mundësitë në bashkëpunim në shumë fusha përfshirë në mbrojtje dhe në energji "janë të pakufishme", duke shtuar se bizneset amerikane kërkojnë partnerë të besueshëm.

Në ngjarjen e organizuar nga kjo ambasadë për 250-vjetorin e shtetësisë amerikane, Prattipati tha se shteti i saj mezi pret të rrisë partneritetin me Kosovën, sepse, sipas saj një Kosovë stabile, prosperuese nuk është gjë e mirë vetëm për popullin e saj, por edhe për Evropën e botën.

Sipas diplomates amerikane, miqësia mes ShBA-së dhe Kosovës bazohet në vlera të përbashkëta, respekt të ndërsjellë dhe besimi se e ardhmja definohet nga mundësitë dhe siguria. "Teksa Kosova vazhdon të zhvillohet dhe të thellojë integrimin e saj

në komunitetin ndërkombëtar, mundësitë për bashkëpunim, veçmas në mbrojtje, tregti, investime ekonomike dhe energji, janë të pakufishme. Bizneset amerikane po kërkojnë partnerë të besueshëm, fuqi punëtore dhe tregje konkurruese. Kosova ka mundësi që të jetë të tri këto gjëra", tha ajo.

Këto deklaratat të Prattipati vijjnë pasi ajo javëve të fundit i ka bërë thirrje Qeverisë në detyrë të Kosovës që t'i bashkohet nismave rajonale të gazit të lëngshëm natyror (LNG) amerikan, duke argumentuar se kjo do t'i ndihmonte vendit të sigurojë të ardhmen e vet energjetike.

Qeveria në detyrë, që udhëhiqet nga Albin Kurti, ka ngulur këmbë se Kosova nuk është kundër LNG-së amerikane, por ka thënë se e sheh gazifikimin e thëngjillit si mundësi më të mirë sesa furnizimin me LNG-në.

Në ngjarjen e organizuar për 250-vjetorin e pavarësisë së ShBA-së, Prattipati ndërkaq tha



se Kosova "gjithmonë ka qenë pranë nesh, duke mbështetur prioritetet tona", teksa përmendi përfshirjen e vendit në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese dhe në Bordin e Paqes - nismën e presidentit amerikan, Donald

Trump, për zgjidhjen e konflikteve në botë. "Po ashtu edhe ShBA-ja qëndron pranë Kosovës. Ne qëndrojmë me Kosovën në përpjekjet e saj për të ndërtuar institucione të forta, qëndrojmë me Kosovën në

ndërtimin e një ekonomie prosperuese që tërheqë investitorë dhe ofron mundësi për të gjithë qytetarët", tha Prattipati.

Në këtë ngjarje, ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, falënderoi ShBA-në për ndihmën në çlirim dhe shtetndërtim, duke vlerësuar lart miqësinë mes dy vendeve.

Kosova e konsideron si qenësore aleancën me ShBA-në, shtet që ka kontribuar në pavarësinë dhe shtetndërtimin e saj.

Përveç kontributit në pavarësi dhe shtetndërtim, ShBA-ja po ashtu ka mbështetur procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri, teksa kjo forcë po ashtu pajisjet me armë amerikane.

Përveç mbështetjes që ShBA ka dhënë për shndërrimin e FSK-së në ushtri, Uashingtoni kontribuon në trajnimin dhe edukimin e ushtarëve të Kosovës.

Kosova po ashtu është mikpritëse i bazës më të madhe amerikane në Ballkan, Bondsteel.



KUSARI-LILA: MOSPAJTIMET BRENDA PARTIVE MUND TA VËSHTIRËSOJNË KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

Ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka theksuar të mërkurën se, pas certifikimit të rezultateve, pritet të nisë komunikimi zyrtar ndërmjet partive për krijimin e institucioneve të reja. Sipas saj, mospajtimet dhe qëndrimet e ndryshme brenda partive mund ta vështirësojnë konstituimin e institucioneve dhe arritjen e një dakordimi ndërmjet subjektit fitues të zgjedhjeve dhe partive të tjera, ndërsa ka theksuar se projektet strategjike nuk duhet të përdoren për përplasje politike

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar të mërkurën se pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 7 qershorit pritet të nisë komunikimi zyrtar ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe partive të tjera politike për krijimin e institucioneve të reja të Republikës së Kosovës. Ajo ka thënë se koalicioni që përfaqëson do të dalë me një qëndrim zyrtar dhe pret që të njëjtën gjë ta bëjnë edhe subjektet e tjera politike.

Sipas saj, deri më tani ka pasur vetëm deklarime të përgjithshme nga përfaqësues të partive, por jo vendime zyrtare të tyre, me përjashtim të Aleancës. Kusari-Lila shtoi se situata politike pas zgjedhjeve të 7 qershorit është më e ndërlikuar se në proceset e kaluara, pasi, sipas saj, brenda partive të tjera po shfaqen më shumë se një qëndrim për marrëveshje të mundshme politike ose koalicione. Kjo, sipas saj, mund ta vështirësojë themelimin e institucioneve të reja dhe arritjen e një marrëveshjeje. “Deri më tash, të paktën nga ajo që kam dëgjuar, kanë qenë

deklarime të përgjithshme të përfaqësuesve të partive, por jo vendime në nivel të partive. Përfshij Aleancën, e cila ka dalë me një qëndrim konkret. Në momentin e certifikimit të rezultateve duhet të fillojë komunikimi zyrtar, me qëndrime zyrtare. Në rastin tonë, është drejtuesi i partisë më të madhe të koalicionit, kryeministri Albin Kurti. Në anën tjetër janë kryetarët e partive, të cilët duhet ta prezantojnë qëndrimin zyrtar të partisë, por edhe të grupit të deputetëve që përfaqësojnë. Situata është më e ndërlikuar se në zgjedhjet e kaluara, pasi sot brenda një grupi parlamentar ose një subjekti politik ka dy ose tri qëndrime. Kjo po e vështirëson dhe do ta vështirësojë edhe më tej konstituimin e institucioneve dhe arritjen e një dakordimi ndërmjet subjektit fitues të zgjedhjeve dhe partive të tjera”, është shprehur Kusari-Lila. E pyetur për kërkesat e Aleancës që kjo parti të mbështesë proceset institucionale, Kusari-Lila ka theksuar se ato çështje duhet të trajtohen në kuadër të diskutimeve për programin qeverisës. Duke folur për kushtin që disa parti kanë vendosur për përfshirje në bisedime me

Vetëvendosjen, konkretisht çështjen e gazit amerikan, kryetarja e Alternativës tha se kjo temë nuk duhet të shfrytëzohet për beteja të brendshme politike. “Sa i përket projekteve, besoj se ato diskutohen në kuadër të programit qeverisës. Nëse një parti vendos kushte të kësaj natyre, por nuk bëhet pjesë e qeverisë, atëherë ato humbin kuptimin. Ndërsa sa i përket këtij projekti, i cili është politizuar tepër shumë, nuk besoj se i bën nder askujt, as bashkëpunimit dhe raporteve tona me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që projektet strategjike në fushën e energjisë të shfrytëzohen për beteja të brendshme politike. Ka nevojë për diskutim dhe debat përmbajtësor, por jo për debate me akuza e kundërakuza për një projekt që do t'i tejkalojë mandatet e të gjitha qeverive”, ka thënë ajo. Kusari-Lila u pyet edhe për emra të mundshëm për postet në institucionet e reja, por tha se nuk mund të flasë për to, pasi kjo çështje do të diskutohet në bisedimet eventuale ndërmjet partive politike. Ajo përmendi edhe propozimin e mëhershëm të Vetëvendosjes për ta votuar Feride Rushitin për presidente, duke theksuar

se partitë opozitare atëherë nuk kishin ofruar asnjë propozim konkret. “Nuk mund të flas për emra, sepse ky është një proces që është lënë të diskutohet ndërmjet partive politike. Është thënë se priten edhe rekomandime të tjera. Feride Rushiti ishte një rekomandim në një kohë kur partitë opozitare nuk kishin dhënë asnjë propozim apo emër publik. Ndoshta ka ardhur momenti që gjërat të trajtohen më seriozisht, duke filluar nga qëndrimet zyrtare të subjekteve politike, të cilat garantojnë edhe mbështetjen e deputetëve të tyre. Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës, herën e kaluar, nuk kanë pasur propozime konkrete”, ka thënë Kusari-Lila. Ndërkaq kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar të mërkurën se janë në pritje të certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 7 qershorit dhe afatit të ankesave, para se të fillojnë diskutimet për formimin e Qeverisë. “Së pari duhet ta presim certifikimin e rezultateve dhe trajtimin e ankesave, dhe pastaj pa humbur kohë do të kemi komunikimet dhe diskutimet e nevojshme”, ka deklaruar Kurti shkurt për gazetarët.

Prezantohet raporti i përgjithshëm mbi inspektimet

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në prezantimin e Raportit të Përgjithshëm mbi Inspektimet për vitin 2025 nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Në fjalën hapëse, kryeministri në detyrë Kurti tha se, në mandatin e kaluar, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës hodhën hapin e parë legjislativ drejt një reforme gjithëpërfshirëse të sistemit të inspektimit duke miratuar Ligjin për Inspektimet.

Ai shtoi se në raport evidentohet progres i dukshëm në zbatimin e kësaj reforme. "Inspektimet nuk janë vetëm një çështje teknike apo administrative; ato janë një nga mënyrat më konkrete përmes të cilave shteti i drejtë tregon se ligji nuk është fjalë në letër, në vendin e punës, në ushqimin që konsumojmë, në produktet që blejmë, në shërbimet që i marrim dhe në mjedisin ku jetojmë", theksoi kryeministri në detyrë Kurti.

Ai nënvizoi se përveç ndryshimeve, me të cilat

Qeveria synon të mbështesë dhe të bashkëpunojë me sektorin privat, reforma ligjore po ashtu e ka për qëllim forcimin dhe përmirësimin e punës së vet inspektorateve dhe personelit të tyre.

Teksa theksoi se është e rëndësishme që inspektimet të mos kthehen asnjëherë në mjet presioni, favorizimi apo keqpërdorimi, kryeministri shtoi se "qeverisja jonë e ka pasur dhe vazhdon ta ketë të qartë: korrupsioni luftohet jo vetëm duke ndëshkuar posteriori rastet kur ato



ndodhin, por duke ndërtuar sisteme që i zvogëlojnë mundësitë e hapësirat për arbitraritet, për pazare, për ndërhyrje dhe për trajtim të pabarabartë".

BE-ja KËRKON PËRSHPEJTIMIN E REFORMAVE NË KOSOVË NË TAKIMIN E KOMITETIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 KORRIK - Jeton Zulfaj, kryenegociator i Kosovës me Bashkimin Evropian, dhe Valentina Superti, drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi Lindore (DP ENEST), hapën në Prishtinë takimin e 7-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Sipas njoftimit për medie të Qeverisë, Komiteti, i bashkëkryesuar nga Arben Krasniqi, sekretar i përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit, dhe Jiri Plecity, shef i Njësisë së DP ENEST përgjegjëse për Kosovën, shqyrtoi zhvillimet kryesore politike gjatë periudhës së fundit dhe bëri një vlerësim të gjendjes së zbatimit të kriterëve politike dhe ekonomike, përafrimit me legjislacionin dhe standardet e BE-së, si dhe të zbatimit të obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA).

Diskutimet u përqendruan në prioritetet e reformave në një gamë të gjerë fushash, duke u mbështetur dhe duke miratuar rezultatet e mbledhjeve të nënkomiteteve sektoriale dhe



grupeve të veçanta të mbajtura në kuadër të ciklit të shtatë të Dialogut për Stabilizim-Asociimit. Duke njohur përparimet e arritura në disa fusha, BE-ja nënvizoi rëndësinë e institucioneve plotësisht funksionale për përsheptimin e nevojshëm të procesit të reformave. BE-ja theksoi se e ardhmja evropiane e Kosovës mbetet

përpjekje e tërë shoqërisë, e mbështetur nga një konsensus i gjerë dhe i qëndrueshëm publik. Në këtë kontekst, bashkëpunimi i shtuar ndërmjet partive politike, konsultimi kuptimplotë me shoqërinë civile dhe angazhimi me pushtetin lokal mbeten faktorë të rëndësishëm për avancimin e agjendës evropiane të Kosovës.

BE-ja mirëpriti përparimin në fushat që lidhen me konkurrueshmërinë dhe rritjen gjithëpërfshirëse, veçanërisht në politikën sociale dhe punësim, transformimin digjital, tatimet, politikën ekonomike dhe monetare, arsimin dhe kulturën, dhe doganat. Duke njohur përparimet e arritura së fundmi në demokraci dhe sundimin e

ligjit, BE-ja theksoi nevojën për të përsheptuar dhe prioritetizuar reformat që janë në pritje, veçanërisht në administratën publike, lirinë e shprehjes, sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave themelore dhe të drejtave të personave që u përkasin komuniteteve joshumicë.

Qeveria e Kosovës vuri në pah përparimet e arritura dhe rikonfirmoi përkushtimin e saj për avancimin e agjendës së reformave, zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe shfrytëzimin e plotë të mundësive që ofron Plani i Rritjes i BE-së për Ballkanin Perëndimor për të përsheptuar zhvillimin socio-ekonomik dhe përparimin në rrugën evropiane.

Të dyja palët u pajtuan të vazhdojnë angazhimin e tyre në dobi të procesit të reformave të Kosovës dhe aspiratave të saj evropiane.

Si partneri më i fuqishëm dhe më i besueshëm i Kosovës dhe ofruesi më i madh i asistencës financiare, që ka investuar më tepër se 3.7 miliardë euro në Kosovë që nga viti 1999, BE-ja konfirmoi përkushtimin e saj për të mbështetur përparimin e Kosovës në rrugën e saj evropiane.

Fillojnë patrullimet e përbashkëta policore Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 1 KORRIK - Nga data 1 korrik 2026 kanë nisur patrullimet e përbashkëta të zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet dy policive.

Ky angazhim i përbashkët synon forcimin e bashkëpunimit profesional, rritjen e sigurisë rrugore dhe ofrimin e një shërbimi sa më efikas për

qytetarët dhe të gjithë përdoruesit e rrugëve, veçanërisht gjatë sezonit veror kur qarkullimi ndërmjet dy vendeve shënon rritje të konsiderueshme.

Patrullimet realizohen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë ndërmjet dy policive, duke reflektuar partneritetin e ndërtuar ndër vite dhe angazhimin e përbashkët për rritjen e sigurisë publike, parandalimin e aksidenteve në trafik dhe respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor.

Policia e Kosovës vlerëson lart bashkëpunimin me Policinë e Shtetit Shqiptar dhe mbetet e përkushtuar në zhvillimin e iniciativave të përbashkëta që kontribuojnë në sigurinë e qytetarëve të të dy vendeve. "Ftojme të gjithë pjesëmarrësit në trafik që të respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor, të tregojnë kujdes të shtuar gjatë udhëtimit dhe të kontribuojnë në krijimin e një ambienti sa më të sigurt për të gjithë", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.



KEK-u nis reforma të thella në menaxhimin dhe mbrojtjen e pronave të Korporatës

PRISHTINË, 1 KORRIK - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A.) ka njoftuar se ka realizuar me sukses unifikimin e evidencave të pronave të saj dhe ka filluar një proces të gjerë reformash me fokus të veçantë në identifikimin, trajtimin e rasteve të uzurpimit, mbrojtjen dhe konsolidimin e pronës së Korporatës.

Në kuadër të këtij procesi, përveç komunave të Obiliqit dhe Fushë-Kosovës, ku KEK zhvillon aktivitetet e saj operative, janë identifikuar prona të Korporatës edhe në komuna të tjera të Republikës së

Kosovës, përfshirë Podujevën dhe Brezovicën.

Për këtë qëllim, KEK-u ka intensifikuar bashkëpunimin institucional dhe është duke zhvilluar takime me drejtuesit e komunave përkatëse dhe institucionet kompetente, me qëllim të identifikimit dhe trajtimit të rasteve të uzurpimit, mbrojtjes së pronës publike dhe rikthimit të pronave në administrim të rregullt institucional.

Njëkohësisht, KEK Sh.A. inkurajon të gjithë qytetarët dhe subjektet që eventualisht shfrytëzojnë prona të

Korporatës pa bazë ligjore që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për lirim vullnetar të tyre sa më parë. “Ky proces zhvillohet paralelisht me programin më të madh investiv në historinë e KEK-ut, i cili përfshin modernizimin e njësive gjeneruese pas më shumë se katër dekadave dhe zhvillimin e projekteve në fushën e energjisë së ripërtëritshme, duke dëshmuar përkushtimin e Korporatës për reformim të gjithanshëm, mbrojtje të asetëve publike dhe menaxhim të përgjegjshëm institucional”, ka njoftuar KEK-u.



GJYKATA SHQIPTON DËBIM, NDALIM HYRJEJE NË KOSOVË DHE GJOBA PËR TË NDALUARIT NË GAZIMESTAN

PRISHTINË, 1 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shqiptuar masën e dëbimit dhe ndalimin e hyrjes në Kosovë për tre vjet, si dhe gjoba për personat e ndaluar në Gazimestan gjatë shënimit të Vidovdanit, më 28 qershor, të cilët akuzoheshin për “shkaktim të trazirave dhe cenim të rendit dhe qetësisë publike”. Masa e dëbimit dhe ndalimi i hyrjes në Kosovë vlej në për shtetasit e huaj që nuk posedojnë dokumente të Kosovës.

Policia e Kosovës kishte ndaluar 37 persona, por para gjykatës u proceduan 36 prej tyre. Ata janë kryesisht nga Serbia dhe vendet e rajonit dhe të ndaluarve u ishin konfiskuar dokumentet personale deri në shpalljen e aktgjykimit.

Gjyqtarja e çështjes, Naime Krasniqi, tha se dokumentet nuk do t'u kthehen të 36 personave derisa ta paguajnë gjobën prej 700 eurosh.

Ajo e arsyetoi vendimin e gjykatës për t'i shpallur fajtorë me faktin se të akuzuarit kishin brohoritur “Kosova është Serbi” dhe duke ngritur tre gishtat lart, gjë që, sipas Krasniqit, konsiderohet mesazh nacionalist.

Ajo theksoi se Policia e Kosovës, para fillimit të shënimit të Vidovdanit në Gazimestan, afër Prishtinës, i kishte paralajmëruar të pranishmit se ishte e ndaluar shfaqja e çdo simboli që nxit “urrejtje ndëretnike, fetare ose politike”. Serbët nga Kosova, Serbia dhe vendet e rajonit mblidhen



tradicionalisht çdo 28 qershor në Gazimestan për të shënuar Vidovdanin, që është edhe festë fetare, në përkujtim të betejës kundër Perandorisë Osmane më 1389.

Ndërkohë, në opinion janë shfaqur pretendime se

personat e ndaluar gjatë shënimit të Vidovdanit në Gazimestan janë keqtrajtuar “psikologjikisht dhe fizikisht” nga zyrtarët policorë të Kosovës.

Radio Evropa e Lirë nuk ka arritur t'i verifikojë në mënyrë

të pavarur këto pretendime, ndërsa nga Inspektorati Policor i Kosovës kanë bërë të ditur se do t'i hetojnë këto pretendime, ato sipas detyrës zyrtare, megjithëse thanë se nuk kanë pranuar asnjë ankesë lidhur me ngjarjet në Gazimestan.

Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe ka dënuar ndalimet gjatë shënimit të Vidovdanit në Gazimestan, duke e vlerësuar këtë si një “akt të turpshëm dhe të padenjë represioni”.

Gazimestani në Kosovë njihet gjithashtu për fjalimin që udhëheqësi i atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq, mbajti atje në vitin 1989.

Ky fjalim shpesh përmendet si hyrje në konfliktet e armatosura që pasuan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë.

GJYKATA SUPREME HEDH POSHTË SI TË PALEJUESHME PADINË E QEVERISË KUNDËR ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 1 KORRIK - Oda e Avokatëve e Kosovës ka njoftuar se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me aktvendimin P.A.nr.17/2026, ka hedhur poshtë si të palejueshme padinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministrisë së Drejtësisë, të ushtruar kundër Odës së Avokatëve të Kosovës. Me këtë aktvendim, tentativa e Qeverisë për të vënë në diskutim aktet e Odës nuk arriti të kalojë as filtrin fillestar të lejueshmërisë procedurale.

Gjykata Supreme konstatoi se objekti i padisë nuk hyn në kompetencën e saj, duke e hedhur poshtë padinë si të palejueshme, pa hyrë në



shqyrtimin e meritës së pretendimeve. “Ky zhvillim është një rikujtim se në një shtet të së drejtës, kompetencat nuk ushtrohen sipas vullnetit politik, por vetëm në bazë të Kushtetutës

dhe ligjit. Asnjë institucion nuk mund të zgjerojë kompetencat e veta përtej atyre që i janë dhënë shprehimisht me ligj. Oda e Avokatëve e Kosovës nuk do të njohë dhe nuk do të zbatojë

asnjë vendim, akt apo urdhër të nxjerrë nga organe që veprojnë jashtë kompetencave të tyre ligjore. Çdo ndërhyrje e tillë është juridikisht e pabazuar dhe nuk prodhon pasoja juridike ndaj Odës së Avokatëve. Përpjekjet e fundit për të ndërhyrë në organizimin e brendshëm dhe ushtrimin e kompetencave të Odës dëshmojnë një keqkuptim serioz të parimeve themelore mbi të cilat ndërtohet shteti demokratik, parimit të ligjshmërisë, ndarjes së pushteteve dhe vetëqeverisjes së profesioneve të lira”, ka njoftuar Oda e Avokatëve e Kosovës. Thuhet tutje se autonomia e

Odës së Avokatëve nuk është privilegj institucional, por garanci kushtetuese për mbrojtjen e pavarësisë së avokatit dhe të së drejtës së qytetarëve për një mbrojtje të lirë e të pavarur.

Oda e Avokatëve ka theksuar se do të vazhdojë të mbrojë pa kompromis kompetencat që i garantohen me Kushtetutë dhe Ligjin për Avokatinë dhe do të kundërshtojë me të gjitha mjetet juridike çdo akt të nxjerrë ultra vires, nga cilido institucion apo autoritet publik.

Vendimi i Gjykatës Supreme është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankesë.

Kryeqyteti investon 333 mijë euro për Brigadën Profesionale të Zjarrfikësve, shtohet një kamion i ri

PRISHTINË, 1 KORRIK - Komuna e Prishtinës ka investuar 333 mijë euro për fuqizimin e Brigadës Profesionale të Zjarrfikësve, duke shtuar në flotën e saj një kamion të ri sulmues për intervenime në

situata emergjente. Sipas njoftimit, ky investim do të rrisë ndjeshëm kapacitetet operative të brigadës, duke mundësuar reagim më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikas në

mbrojtje të jetës së qytetarëve, pronës dhe mjedisit.

Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se investimet në shërbimet emergjente do të vazhdojnë edhe në të

ardhmen, me synim përmirësimin e kushteve të punës dhe fuqizimin e kapaciteteve të zjarrfikësve, të cilët çdo ditë janë në vijën e parë të mbrojtjes dhe sigurisë së qytetarëve.



SENATI I UP-së MIRATON VENDIME STRATEGJIKE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK, PROGRAMET E REJA TË STUDIMIT DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2026, mori një sërë vendimesh me rëndësi për forcimin e integritetit akademik, avancimin e cilësisë në arsim dhe zhvillimin e mëtejshëm institucional të universitetit.

Me votim unanimit, senatorët miratuan Konkluzionin për ruajtjen e integritetit akademik, standardeve etike dhe reputacionit të Universitetit të Prishtinës, me qëllim të garantimit të transparencës dhe besueshmërisë në proceset e emërimit, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik. Në kuadër të këtij angazhimi, Senati miratoi edhe propozimin për emërimin e një komisioni ad hoc për shqyrtimin e pretendimeve për plagjiaturë

lidhur me pozitat nr. 4 dhe nr. 12 në Fakultetin e Arteve. Po ashtu, senatorët shqyrtuan një ankesë të paraqitur kundër një vendimi të Këshillit të Etikës.

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në universitet, Senati miratoi Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, Udhëzuesin për Sigurimin e Cilësisë dhe Udhëzuesin për organizimin e provimeve pranuese në Universitetin e Prishtinës.

Një nga pikat kryesore të rendit të ditës ishte edhe miratimi për akreditim i disa programeve të reja të studimit, duke zgjeruar ofertën akademike të universitetit dhe duke kontribuar në zhvillimin e programeve bashkëkohore në përputhje me nevojat e arsimit të lartë.

Senati vazhdoi gjithashtu procedurat e emërimit, rizgjedhjes dhe avancimit të



personelit akademik në Fakultetin e Filologjisë, Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin Filozofik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore. Në fushën e studimeve të doktoratës, senatorët miratuan tri tema të reja të doktoratës me mentorët përkatës dhe ratifikuan

edhe tri tema të tjera, ndërsa u miratuan edhe redaktorët profesionalë për tri tekste universitare. Senati po ashtu miratoi propozimin për emërimin e hapësirave në kampuset e Universitetit të Prishtinës me emrat e profesorëve "Ejup Stavovci" dhe "Eshref Ademaj", në nderim të kontributit të tyre për universitetin dhe shoqërinë.

Gjithashtu, u miratua hapja e një pozite të re për profesor në Fakultetin e Mjekësisë, si pjesë e përfundimit të kapaciteteve akademike të këtij fakulteti. Vendimet e marra në këtë mbledhje pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Senatit për forcimin e cilësisë akademike, ruajtjen e integritetit institucional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Universitetit të Prishtinës.

MASH ORGANIZOI TRYEZË TË DISKUTIMIT ME PARTNERË ZHVILLIMORË PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË ARSIMIT 2035+

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka organizuar tryezën e parë të diskutimit me partnerë zhvillimorë të fushës së arsimit, në kuadër të procesit të hartimit të Strategjisë së re të Arsimit të Kosovës 2035+.

Takimi kishte për qëllim njoftimin e partnerëve zhvillimorë me qasjen metodologjike dhe procesin e hartimit të Strategjisë së re, e cila do të përcaktojë prioritetet strategjike që do të udhëheqin zhvillimin e sektorit të arsimit në dekadën e ardhshme. Në fjalën e tij, ministri në detyrë i Arsimit dhe Shkencës, Hajrulla Çeku shprehi mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve zhvillimorë në fushën e arsimit.

Ai theksoi se arritjet në sistemin arsimor janë, ndër të tjera, rezultat edhe i kontributit të tyre shumëvjeçar dhe shtoi se procesi i hartimit të Strategjisë së re



paraqet një mundësi për thellimin e partneritetit, jo vetëm në hartimin e dokumentit, por edhe në zbatimin e tij. Ministri në detyrë Çeku bëri të ditur se Strategjia e re do të hartohet përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultativ, me pjesëmarrjen e institucioneve, partnerëve zhvillimorë, ekspertëve, organizatave të shoqërisë civile, nivelit lokal, profesionistëve, si dhe akterëve të tjerë relevantë. Ai shpallti katër prioritetet kryesore mbi të cilat do të bazohet qasja strategjike afatgjatë në fushën e arsimit: edukimin dhe parandalimin e hershëm,

përmirësimin e arsimit parauniversitar përmes zhvillimit të shkollës gjithëditore, fuqizimin e arsimit dhe aftësimin profesional në funksion të tregut të punës, si dhe ristrukturimin e arsimit të lartë. Koordinator i procesit të hartimit të Strategjisë së re, Taulant Hoxha, prezantoi kornizën metodologjike, strukturën menaxhuese dhe afatet kryesore të procesit. Ai theksoi se Strategjia e Arsimit 2022 - 2026 ka krijuar një bazë të rëndësishme për avancimin e reformave në sektorin e arsimit, duke shënuar progres në fusha prioritare, ndërsa Strategjia e re

synon të ndërtohet mbi arritjet ekzistuese dhe të krijojë një kornizë zhvillimore afatgjatë e që u përgjigjet nevojave të shoqërisë dhe sfidave të dekadës së ardhshme. Gjithashtu, ai theksoi qasjen e bazuar në pronësi të shtuar vendore e institucionale në hartimin dhe zbatimin e strategjisë së re, si shtyllë mbi të cilën do të orientohet edhe përkrahja e partnerëve ndërkombëtarë në të ardhmen. Në takim morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të partnerëve kryesorë zhvillimorë në Kosovë, përfshirë Bashkimin Evropian, Bankën Botërore, Agjencinë Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ), Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), Agjencinë e Luksemburgut për Zhvillim Ndërkombëtar (LuxDev), OSBE-në, Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS),

Millennium Challenge Account (MCA), DVV-së, si dhe projektet KosEd dhe Swisscontact. Të gjithë partnerët zhvillimorë shprehën gatishmërinë për të vazhduar mbështetjen ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës gjatë gjithë procesit të hartimit dhe zbatimit të Strategjisë së re. Ata vlerësuan rëndësinë e një procesi të bazuar në përvojat paraprake, konsultimin e gjerë me palët e interesit dhe koordinimin e vazhdueshëm ndërmjet institucioneve dhe partnerëve zhvillimorë, me synimin që Strategjia e re të kontribuojë në rritjen e cilësisë, gjithëpërfshirjes, qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së sistemit arsimor në Kosovë. Tryeza e sotme shënoi fillimin zyrtar të procesit të përgatitjes së Strategjisë së re të Arsimit të Kosovës, dhe ishte e para në radhën e një serie të tryezave të diskutimit me akterë, hisederarë, njohës dhe të interesuar në fushën arsimit.

Qindra analiza laboratorike çdo ditë në QKUK, Biokimia Mjekësore në shërbim të pacientëve

PRISHTINË, 1 KORRIK - Çdo ditë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës realizohen qindra analiza laboratorike që luajnë rol vendimtar në diagnostikimin dhe monitorimin e pacientëve. Këto shërbime ofrohen nga ekipi i Biokimisë Mjekësore, një nga njësitë kryesore diagnostike të QKUK-së.

Brenda një dite, në Klinikën e Biokimisë Mjekësore pranohen dhe përpunohen mostrat

biologjike të rreth 100 - 150 pacientëve ambulatorë dhe 400 - 550 pacientëve të hospitalizuar, pa përfshirë pacientët në programin e dializës. Klinika realizon një gamë të gjerë analizash biokimike, hematologjike, imunologjike, hormonale, tumorale, virale, autoimune, të hemostazës dhe koagulimit, si dhe analiza të tjera specifike, duke mbështetur diagnostikimin, monitorimin

dhe trajtimin e pacientëve në të gjitha klinikat e QKUK-së. Në kuadër të saj funksionojnë laboratorët me shërbim 24-orësh në Klinikën Emergjente, Klinikën Infektive, Kirurgji dhe Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, si dhe laboratorët në klinikat e tjera të QKUK-së. Gjithashtu, Klinika mbulon edhe Laboratorin e Skriningut Neonatal, i cili ka filluar punën e rregullt gjatë vitit të fundit, duke

shënuar një hap të rëndësishëm në diagnostikimin e hershëm të të porsalindurve. Për ofrimin e këtyre shërbimeve, Klinika përdor platforma moderne diagnostike të prodhuesve të njohur ndërkombëtarë, të njëjta me ato që aplikohen në qendrat më të avancuara shëndetësore, duke garantuar rezultate të sakta, të besueshme dhe në kohë për pacientët.



Paga minimale në Kosovë rritet në 500 euro

PRISHTINË, 1 KORRIK - Paga minimale në Kosovë është rritur në 500 euro, ka bërë të ditur kryeministri në detyrë, Albin Kurti përmes një postimi në rrjetet sociale.

Kurti ka rikujtuar se paga minimale kishte mbetur e pandryshuar për më shumë se dhjetë vjet. "Paga minimale në

vendin tonë ngeli e pandryshuar për më shumë se 10 vjet. 2011 ishte viti i fundit kur ajo u ndryshua. Që prej atëherë ajo mbeti 130 përkatësisht 170 euro (varësisht se a je nën apo mbi 35 vjeç)", ka shkruar ai.

Sipas tij, gjatë qeverisjes së tij paga minimale është rritur katër herë. "Ndërkaq, gjatë qeverisjes

sonë u ngrit katër herë: nga 130 e 170 euro në 250 euro, mandej në 350 dhe së fundi në 425 euro. E sot paga minimale u bë 500 euro. Prej kësaj rritjeje do të përfitojnë rreth 150 mijë punëtorë të sektorit privat", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se, sipas tij, paga minimale është trefishuar gjatë

mandatit të qeverisë së tij. "Pra, për më shumë se një dekadë para qeverisjes tonë paga minimale ishte e ultë dhe e pandryshueshme. Ndërkaq për më pak se gjysmë dekadë me ne, kemi trefishim të pagës minimale. Rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Republikës sonë do ta



përcjellim gjithnjë me shtim të mirëqenies për të gjithë. Urime të gjithëve!", ka përfunduar Kurti.

AKB-ja: RITJA E PAGËS MINIMALE DUHET TË BAZOHET NË LIGJ, E PADREJTË QË U PËRJASHTUAN VETERANËT E UÇK-së

PRISHTINË, 1 KORRIK - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka mbështetur parimisht rritjen e pagave dhe përmirësimin e mirëqenies së punëtorëve, por kundërshton mënyrën se si Qeveria e Kosovës ka vendosur rritjen e pagës minimale në 500 euro. "Sipas legjislacionit në fuqi, paga minimale nuk duhet të ndryshohet me vendime të njëanshme, por mbi bazën e kritereve të përcaktuara me ligj dhe pas konsultimeve në Këshillin Ekonomik-Social (KES). Ligji parasheh që gjatë përcaktimit të pagës minimale të merren në konsideratë tregues ekonomikë dhe socialë, si: shkalla e inflacionit, kostoja e jetesës, niveli i pagave, produktiviteti i punës, zhvillimi ekonomik, niveli i punësimit dhe



gjendja në tregun e punës", është thënë në reagimin e AKB-së.

AKB-ja pyet publikisht Qeverinë e Kosovës se: Cilat nga kriteret e përcaktuara me ligj janë analizuar dhe janë përdorur si bazë për rritjen e pagës minimale në 500 euro? Ku është analiza ekonomike që dëshmon

se ekonomia dhe bizneset kanë kapacitet ta përballojnë këtë rritje? Pse është anashkaluar Këshilli Ekonomik-Social, institucioni i krijuar me ligj për të ndërtuar konsensus ndërmjet Qeverisë, punëdhënësve dhe punëmarrësve? "AKB-ja vlerëson se vendimet që nuk mbështeten

në analizë ekonomike dhe dialog social rrezikojnë të rrisin ekonominë joformale, të dëmtojnë konkurrueshmërinë e bizneseve, të rëndojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe të ndikojnë negativisht në punësim. Po ashtu, AKB-ja rikujton se ka qenë organizata e vetme ekonomike që ka kundërshtuar publikisht përjashtimin e veteranëve të UÇK-së nga përfitimi i pagës minimale. Ky përjashtim është i padrejtë dhe bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë. Vendimi do të ishte më i drejtë dhe më gjithëpërfshirës po të mos i linte veteranët jashtë këtij mekanizmi", është thënë në këtë reagim.

Ndërkaq kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka deklaruar se nuk

është kundër rritjes së pagës minimale. "Përkundrazi, ne mbështesim çdo rritje që bazohet në ligj, analiza ekonomike dhe dialog social. Vendimet e njëanshme krijojnë pasiguri për bizneset dhe rrezikojnë ta shtyjnë ekonominë drejt informalitetit. Qeveria duhet të sqarojë se cilat kritere ligjore ka zbatuar për këtë vendim dhe pse nuk është respektuar roli i Këshillit Ekonomik-Social. AKB-ja i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që të respektojë ligjin, të rikthejë dialogun social dhe të marrë vendime ekonomike mbi baza profesionale, në interes të punëtorëve, bizneseve dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit", ka thënë Shahini.

REFORMAT, FONDI I INOVACIONIT DHE FUQIZIMI I GRAVE NË BIZNES NË QENDËR TË TAKIMIT KUSARI - SUPERTI

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, priti në takim drejtoreshën për Zgjerim dhe Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Valentina Superti, me të cilën diskutoi për prioritetet e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me theks të veçantë në zbatimin e Agjendës së Reformave dhe avancimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Gjatë takimit, ministrja Kusari-Lila prezantoi progresin e arritur nga MINTI në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zbatimin e reformës në administratën publike, si pjesë e përpjekjeve për ndërtimin e institucioneve më efikase dhe më të përgjegjshme.

Ajo njoftoi gjithashtu për ecurinë e Projektligjit për Ndërmarrësi dhe Inovacion, si dhe Projektligjit

për Kamatvonesat, të cilat priten të krijojnë bazën për reforma të rëndësishme në mbështetje të sektorit privat.

Në takim u diskutua edhe për themelimin e Fondit të Inovacionit, krijimin e skemave të reja mbështetëse për gratë ndërmarrëse, startup-et dhe inovatorët, me synim zhvillimin e ekosistemit të ndërmarrësisë dhe inovacionit në Kosovë.

Po ashtu, bashkëbisedueset trajtuan barrierat tregtare me Serbinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim krijimin e një tregu më funksional, më të integruar dhe më konkurrues.

Pjesë e diskutimit ishte edhe tranzicioni i gjelbër, zhvillimi i parqeve eko-industriale dhe fuqizimi i grave në biznes përmes nismave konkrete, përfshirë konferencën "She Rises 2026" dhe krijimin e një njësie të veçantë në kuadër të agjencisë së



re për ndërmarrësi, e cila do t'i dedikohet mbështetjes së grave ndërmarrëse.

Ministrja Kusari-Lila theksoi se

bashkëpunimi i ngushtë me Komisionin Evropian mbetet i një rëndësie të veçantë për avancimin e reformave, rritjen e

koncurrueshmërisë së ekonomisë dhe përshejtimitin e rrugës së Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Qeveria në detyrë themelon "Fondin e Konfiskimit"

PRISHTINË, 1 KORRIK - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, ka zhvilluar mbledhje elektronike, në të cilën ka miratuar Raportin e Konsoliduar Vjetor për Funksonimin e

Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, në Subjektet e Sektorit Publik, për vitin 2025.

Gjithashtu ka miratuar vendimin për autorizimin e Ministrisë së

Financave që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për hapjen e llogarisë së dedikuar, në kuadër të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTH) me emërtimin "Fondi i Konfiskimit". "Llogaria e

dedikuar do të shërbejë vetëm për pranimin dhe evidentimin e të hyrave nga konfiskimi i pasurisë me vendim të formës së prerë", është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë.



HISTORIA E ERRËT E PERANDORISË ROMAKE: GJAK, KOMPLOTË DHE LUFTA PËR PUSHTET

Qysh nga themelimi, Roma ka njohur domethënien e fjalës dhunë. Jo vetëm ushtarake: komplete gjakësore kanë shenjuar politikën e saj.

Nëse historia e perandorëve të Romës do të kishte një ngjyrë, ajo do të ishte e kuqja. E reduktuar në dy hije, njëra e kuqe e purpurt (ngjyrë fisnike e lidhur me konceptin e mbretërisë) dhe tjetra e gjakut të kuq, ajo mbuloi fytyrat dhe trupat e shumë perandorëve.

Në fillimet e perandorisë, procesi i kalimit të stafetës perandorake ishte në fakt i rregulluar nga norma shumë pak të qarta. Kjo gjë ndikoi në shpërthime luftërash për pushtet, ku gjithçka varej nga autoriteti, lakmia, zgjuarsia dhe nga disponueshmëria për të vuarë – ose për të kandisur për të vuarë pretendentët për fronin. Në pesë shekuj jetë të perandorisë romake pothuajse gjysma e perandorëve vdiqën të vuarë në komplete të pistë, në një alternativë të papushim të grushteve të shtetit dhe kompleteve.

Historia e errët e Perandorisë: PAX ARMATA

Ata që kishin më shumë kredibilitet ishin gjeneralët-perandorë, zotërinj të luftës që si udhëheqësit modernë, fituan shpesh një pushtet absolut. “Nëse perandori i parë qe Augusti, ideja e një perandorie mori formë me Jul Cesarin; një njeri që vdiq nga thikat e komplotit të senatorëve”, tregon historiani i lashtësisë Antonio Montesanti, i Universitetit të Eceter (Angli). “Dhe nëse që në fillimet e saj, perandoria u la me gjak, rruga e dhunës u ndoq gjatë të gjithë periudhës së artë, ose periudhës së gjatë të paqes – pothuajse dy shekuj – që në kronika ka hyrë si pax romana”. Nga ana tjetër, kur një perandor shkaktonte pakënaqësi tek subjekte të tjerë politikë ose ushtarakë, që kishin pushtet të madh, për shembull midis radhëve të senatit ose të gardës pretoriane, ishte gjithmonë dikush i gatshëm që ta hiqte qafe këtë perandor. E nëse Augusti vdiq në mënyrë natyrore, nën pasardhësin e tij, Tiberiin, oborri nisi t’i ngajë gjithmonë e më shumë një filmi kaotik, në të cilin, shpesh herë morën pjesë edhe gratë. Ndonjë shembull? I njëjti Tiber, që i shpëtoi një komploti prej trupprojës Seian, vdiq pastaj i mbytur në shtratin e tij. Pasardhësi, Kaligula është vuarë me thikë duke ia lënë të pastër

rrugën Klaudit, që i mbylli ditët e tij i helmuar nga bashkëshortja Agripina, nëna e Neronit. Ky i fundit, pasi u bë sovran, do të përballej dhe do të shtypte me gjak një komplot të organizuar nga senatori Pison. Për ta mbyllur rrethin, Agripina do të vritej po nga Neroni. Afër fundit të shekullit të I-rë, regjistron vrasjet e perandorëve Galba, Vitelli e Domiciani. Ky i fundit spikat si një nga sovranët më të egër, despotë e të shturur, që do të mposhte gjithashtu prej një komploti të Senatit.

NGA FLORIRI... TEK NDRYSHKU

Në vitin 180, pas vdekjes (natyrore, e çuditshme ta thuash) së Mark Aurelit, u mbyll epoka e artë e perandorisë dhe filloi një periudhë rënieje. Historiani latin Cassio Dione Cocceiano (163-229) e përcaktoi, me një metaforë të famshme, si kalimi “nga një mbretëri e artë, në një prej hekuri e ndryshku”. Dhe ndryshku u bë veçanërisht gërryes me ngjitjen në pushtet të Komodos imponues, i cili pas një manipulimi të të përhershmeve senatorë, i mbylli ditët e tij i vuarë prej gladiatorit që e stërviste për luftë. Vetëm në vitin 193 vdiqën të vuarë pothuaj dy perandorë: Pertinace, nga dora e truprojave, dhe Didio Giulio, nga dora e zakonshme e senatit.

Një fazë veçanërisht delikate ishte zakonisht kalimi dinastik. Kur midis fundit të shek II e fillimit të shekullit III, u afirmua dinastia Severi, u vendos një rekord makabër: përveç themeluesit, Settimio, të gjithë sovranët severianë ishin viktima të kompleteve që u përmbyllën me vrasjen e tyre.

BARBARET

“I fundit i dinastisë Severi, Aleksandri, ishte vuarë nga ushtarët e tij gjatë një kryengritje që solli në pushtet gjeneralin Massimo Trace (235). Kjo ngjarje përbënte një çast vendimtar, duke sjellë një risi: mundësinë që një barbar të bëhej bërë perandor, falë meritave ushtarake”, vazhdon Montesanti.

I ardhur nga një ekular fshatare, Masimo ia doli të ngjitej në shkallën shoqërore falë cilësive luftarake – ishte një kolos i gjatë mbi dy metra – duke udhëhequr ushtrinë romake, për shumë kohë e hapur ndaj të huajve. Në këto



vite u konsolidua një fenomen tashmë i shfaqur me Settimio Severon: çdo aspirant për perandor duhej të llogariste pëlqimin e ushtarëve, me shumë sesa atë të senatorëve. “Në kohën e të ashtuquajturve perandorëve-ushtarakë, nëse një sovran nuk i kënaqte trupat, këta thjesht e hiqnin qafe. Dhe ashtu si në grushtet modernë të shtetit, e zëvendësonin me një gjeneral që e konsideronin më të besueshëm”, shpjegon historiani. “Çdo komandant mundte të aspironte kështu për detyrën e perandorit, por duhej të mbante gjithmonë parasysh faktin që, shumë shpejt mund të rrëzohej”. Po ta shohësh mirë, ishte një trashëgimi arkaike. Para se të merrte mbi vete domethënie politike, fjala perandori i referohej në fakt pushtetit të disa magistratëve ushtarakë, urdhërat e të cilëve, të padiskutueshëm, ishin detyruar edhe në rangje politike dhe fetare.

ANARSHI USHTARAKE

Në shekullin e tretë, për shkak të paqëndrueshmërisë së kufijve, që buronte prej kërcënimit në rritje të popujve barbarë, u janë shtuan rreziqe që kishin si shkak luftërat e brendshme. E gjithë kjo solli anarkinë. “Nëse në dy shekujt e parë raporti midis rangut politik e rangut ushtarak ishte në ekuilibër, ushtria përfundoi duke marrë të gjithë pushtetin, si dhe duke diktuar kohët dhe mënyrat e politikës”, nënvizon Montesanti. “Përqindja e sovranëve të vuarë mbetet gjithmonë e lartë, por nëse në fazën e parë të perandorisë egërsia ishte shpesh e lidhur me manitë dhe me budallallëqet e sovranëve të

veçantë, tani ato që dominonin ishin nevojat e kohës së luftës”. Në vazhden e asaj që ndodhi me Massimo Tracen (i cili nuk e shkeli kurrë Romën), u shtuan sovranët “ekzotikë”. Egzemplar qe rasti i Marko Giulio Filippo, i quajtur arabi. I lindur në tokë siriane, kishte bërë karrierë në ushtri deri sa u bë prefekt pretorian dhe më pas perandor (në vitin 244). Jo pa trashëtuar më parë sovranin paraardhës, Gordiano i III-të, i vuarë nga vetë ushtarët e nxitur nga Filippo. Një kuriozitet: do të jetë tamam ky i fundit që do të festonte një mijë vitet e parë të Romës (e themeluar në 753 p.K.). Pastaj pas njëzet perandorësh të tjerë, kriza e shekullit të tretë u duk se mbaroi falë një komandanti që vinte nga Dalmacia: Diokleziani. Sovrani i ri, i bindur që tashmë dominimi romak kishte shumë fronte të nxehta, jo të kontrollueshme nga një burrë i vetëm, shpiku në vitin 293 të ashtuquajturën tetrarkia, ose “qeveria e të katërve”. Filloi një pezullim i paqëndrueshmërisë politike, por joi dhunës.


LUMENJ GJAKU

Perandoria ishte e ndarë në katër zona dhe Dioklezianit i erdhën në krah tre sovranë të tjerë: Massimiano, Kostanco Klori dhe Galeri. Nëse të katërt, të paktën për pak kohë shmangën luftërat, gjaku u kthye të vërshonte me një “epidemi” të re të persekutimeve kundër të krishterëve. Eksperimenti tetrarkik, gjatë të cilit u alternuan katër perandorë, mori fund në vitin 324. Spektakli u përsërit: lufta civile dhe fitorja finale e më të fortit,

Konstantini i I-rë. “Me themelimin e Kostandinopojës, nga 395-a kryeqyteti i Perandorisë Romake të Lindjes, perandorët e Perëndimit ishin kryesisht sovranë-kukulla”, thotë Montesanti. “Kjo për arsye se fuqia ishte kthyer të përqëndrohej në duart e komandantëve më të mëdhenj ushtarakë, detyrë që në perandorinë e vonë i korrespondonte asaj të magister militum”.

“Një nga me famëkeqët ishte Stilikoni (359-408) me origjinë gjermanike, që shtypi perandorinë pas vdekjes së perandorit Teodos”. Vite më pas, një pushtet i ngjashëm u arrit nga Flavio Ezio (390-454), gjeneral i sovranit Valentiniani i III-të, i cili pasi kishte frenuar gjatë presionin e barbarëve, ishte vuarë në një komplot me pjesëmarrjen e perandorit. Një film i parë tashmë, me një finale të padiskutueshme. Në vitin 455, edhe Valentiniani ishte vuarë, pasi prefekti Petronio Massimo kish dashur ngjitjen në fron, por i destinuar edhe ai të gjente vdekjen e dhunshme: u vra nga populli i tij.

Perdja (e kuqe), e kuqja e purpurt dhe e kuqja e gjakut vazhduan të gërshetohen deri në fund, mbi kanavasin imagjinar që e quajmë Perandoria e Perëndimit. Një kanavas i ngjyer nga shpatat e ushtarëve, në perandorinë e vonë. Dhe do të ishte pikërisht një ushtar, gjermani Odoacre, në kulmin e karrierës në ushtrinë romake, që do të rrëzonte në vitin 476 Romul Auguston. Duke ulur siparin (e kuq) të asaj drame brutale që zgjati pesë shekuj. Focus – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Sunderlandi kërkon mbi 30 milionë euro nga Chelsea për Granit Xhakën

SUNDERLAND, 1 KORRIK - Sunderlandi është duke kërkuar mbi 30 milionë euro për shërbimet e mesfushorit Granit Xhaka, pasi klubi anglez është i pakënaqur me qasjen e Chelsea, i cili ka bërë ofertë zyrtare për shqiptarin. Xhaka është dëshira e madhe e trajnerit Xabi Alonso, ndërsa lojtari raportohet se ka

arritur marrëveshje personale me skuadrën londineze. Megjithatë, Sunderlandi ka refuzuar ofertën e parë prej 8 milionë eurosh, ndërsa "talkSPORT" ka shpjeguar se marrëdhëniet mes dy klubeve nuk janë në nivelin më të mirë, duke bërë që marrëveshja të jetë e vështirë për t'u realizuar. "Sunderlandi po kërkon një

çmim që e tejkalon vlerën e 30 milionë eurove për të konsideruar shitjen e Xhakës. Sunderlandi është i zemëruar sepse i ka bërë të ditur Chelsea se lojtari nuk është në shitje, por megjithatë Chelsea u rikthye me një ofertë prej 8 milionë eurosh", thuhet në raportimin e mediumit britanik. Kësisoj, Sunderlandi

aktualisht po e pengon largimin e Xhakës, të cilin e konsideron një lojtar të rëndësishëm në formacionin bazë edhe për sezonin e ardhshëm. Ndërkohë, Xhaka raportohet se i ka kërkuar Sunderlandit ta lejojë largimin, pasi dëshiron një projekt më ambicioz dhe synon të luftojë për trofe në vitet e fundit të karrierës.



ADEMI URON KLUBET E PROMOVUARA NË KATEGORITË MË TË LARTA TË FUTBOLLIT TË KOSOVËS



PRISHTINË, 1 KORRIK - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka mirëpritur drejtuesit e klubeve të cilët, falë punës së palodhur së bashku me stafet e tyre, përkushtimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të qëndrueshëm, kanë arritur me meritë promovimin në një kategori më të lartë në garat e organizuara nga Federata e Futbollit të Kosovës.

Ademi ka uruar klubet e promovuara, duke u shprehur mirëseardhje në kategoritë e reja: Superliga: FC Vushtrria dhe

FC Feronikeli 74; Liga e Parë: FC Mitrovica dhe FC Lepenci; Liga e Dytë: FC Dardana 10 dhe FC Istogu 03; Superliga e Futsallit: FC Policia dhe FC Rahoveci; si dhe Superliga e Vajzave: FC 2 Korriku.

Presidenti i FFK-së ka theksuar se ky promovim është rezultat i një pune të gjatë, përkushtimit të vazhdueshëm dhe besimit në projektet sportive që secili klub ka ndërtuar ndër vite.

Sipas tij, këto suksese dëshmojnë qartë se puna, organizimi dhe vizioni i mirëfilltë sportiv gjithmonë

shpërblehen me arritje të merituar. "Këto suksese dëshmojnë qartë se puna, organizimi dhe vizioni i mirëfilltë sportiv gjithmonë shpërblehen me arritje të merituar", ka deklaruar Ademi. Ai u ka uruar klubeve të promovuara shumë suksese në ligat përkatëse, me bindjen se ato do të vazhdojnë të forcojnë organizimin profesional, të zhvillojnë kampionate cilësore dhe të japin kontribut të rëndësishëm në avancimin dhe zhvillimin e futbollit dhe futsallit në Kosovë.

NË PARIS PREZANTOHET VIZIONI I KOSOVËS PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESDHETARE 2030

PARIS, 1 KORRIK - Ministri në detyrë i Rinisë dhe Sportit, Blerim Gashani, ka prezantuar në Paris vizionin e Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030, në kuadër të konferencës RIGES 2026, duke theksuar se ky është projekti më i madh zhvillimor në historinë e sportit të vendit. Sipas Gashanit, Lojërat Mesdhetare 2030 nuk do të jenë vetëm një ngjarje

sportive, por edhe një katalizator për investime strategjike, ndërtimin e infrastrukturës moderne, fuqizimin e të rinjve, zhvillimin ekonomik dhe avancimin e diplomacisë sportive. Ai ka theksuar se organizimi i kësaj ngjarjeje do ta vendosë Kosovën në hartën e vendeve organizatore të ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare dhe do të



dëshmojë se vendi është i gatshëm të organizojë evente sipas standardeve më të larta. "Mesazhi ynë është i qartë: Kosova është e hapur për partneritete, për ekspertizë, për inovacion dhe për bashkëpunim ndërkombëtar. Suksesi i Lojërave Mesdhetare do të ndërtohet mbi besimin, miqësinë dhe bashkëpunimin me partnerët tanë", ka deklaruar Gashani.

Ministri në detyrë ka shtuar se rrugëtimi drejt vitit 2030 tashmë ka nisur, duke e cilësuar këtë si fillimin e një epoke të re për sportin kosovar, rininë dhe imazhin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. "Lojërat Mesdhetare 2030 kanë filluar. Tani është koha të ndërtojmë së bashku trashëgiminë që do t'u mbetet brezave", ka përfunduar Gashani.

FC PRISHTINA NDAHET ME NAMANIN, LIMANIN DHE KOLAJN

PRISHTINË, 1 KORRIK - FC Prishtina ka njoftuar për përfundimin e bashkëpunimit me tre futbollistë të skuadrës, Hamdi Namanin, Ardian Limanin dhe portierin Agron Kolaj, të gjitha me marrëveshje të dyanshme.

Mesfushori Hamdi Namani gjatë pjesës vjeshtore të sezonit 2025/26 ka zhvilluar 21 ndeshje me fanellën bardhekaltër, duke realizuar 3 gola dhe 1 asistim. Në pjesën e dytë të sezonit ai ishte i huazuar te Gjilani. Ndërkohë, mbrojtësi Ardian

Limani ka zhvilluar 64 ndeshje zyrtare me Prishtinën, ku ka shënuar 8 gola dhe ka regjistruar 12 asistime. Ai ishte pjesë e skuadrës që fitoi Kupën e Kosovës dhe Superkupën, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në këto

suksese. Largimin e ka konfirmuar edhe portieri Agron Kolaj, i cili pas tri viteve e gjysmë te klubi bardhekaltër ka regjistruar 45 paraqitje zyrtare. Kolaj ishte pjesë e ekipit që fitoi tre trofe: dy herë Kupën e Kosovës dhe një herë

Superkupën e Kosovës. FC Prishtina ka falënderuar të tre futbollistët për përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin e dhënë gjatë periudhës së tyre në klub, duke u uruar suksese në vazhdim të karrierës.

Mbappe vendos rekord të ri në Kupën e Botës

NJU-JORK, 1 KORRIK - Me dy golat e shënuar ndaj Suedisë, Kylian Mbappe i Francës ka vendosur një rekord të veçantë. Ai është lojtari që ka shënuar më së shumti gola në ndeshjet e fazës nokaut në Kampionatet

Botërore. Në ndeshjet me eliminim direkt, Mbappe ka realizuar nëntë gola. Ronaldo dhe Leonidas të Brazilit kanë nga tetë, ndërsa Just Fontaine i Francës dhe Vavá i Brazilit nga shtatë. Mbappe ka

shënuar gola edhe në dy finale të Kampionateve Botërore. Ai është gjithashtu lojtari që ka realizuar më së shpeshti më shumë se një gol në ndeshjet e Botërorit. Në shtatë raste, Mbappe ka shënuar më shumë se një

gol. Ai ka realizuar edhe "hat-trick" në finalen e Botërorit të kaluar. Tashmë, sulmuesi francez ka 18 gola në 18 ndeshje në Kampionatet Botërore. Vetëm Lionel Messi ka një gol më shumë, por në 29 paraqitje.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Fjori F" sh.p.k Dushanovë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin e rërës kuarcore, ne Hoçë e madhe, Komuna Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.08.2026 në ora 11:00 **Kuvendin Komunal të komunës së Rahovecit**, do të organizohet debat publik nga "Fjori F" sh.p.k Dushanovë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Fjori F" sh.p.k Dushanovë, Prizren, për eksploatimin e rërës kuarcore, ne Hoçë e madhe, Komuna Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Durimi" Sh.p.k., Vasilevë, Drenas, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën për riciklimin e mbeturinave të plastikës, në Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.08.2026 në ora 14:30 **ne O "Bora Stankovč" (SHF "Bora Stankovq") rruga Bora Stankovq nr.34 , fshati Koretishtë, Komuna Novo Bërd 16000**, do të organizohet debat publik nga "Durimi" Sh.p.k., Vasilevë, Drenas, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJ57NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Durimi" Sh.p.k., Vasilevë, Drenas, për Pëlqim Mjedisor për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin i gurit gëlqeror në Strazhë, Komuna e Novobërdës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

lindita.morina@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Jaffa Plus L.L.C" Veleknice, Gjilane, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për prodhimin dhe ambalazhimin e lëngjeve freskuese ne bazë të frutave dhe rezervuar te gazit (propan butan) ne kuadër të "Jaffa Plus LLC" ZK. Pasjan, Partash.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.08.2026 në ora 13:30, Objekti Kryesor i Komunës së Parteshit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Jaffa Plus L.L.C" Veleknice, Gjilane, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën e Parteshit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/8981499557?pwd=hGZedJsgauFOTMba2XaGBh2ltN00FJ.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Jaffa Plus L.L.C" Veleknice Gjilane, për prodhimin dhe ambalazhimin e lëngjeve freskuese ne bazë të frutave dhe rezervuar te gazit (propan butan) ne kuadër të Jaffa Plus LLC ZK Pasjan, Partash.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Avril Solar" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812230770 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Avril Solar" D.O.O. Jakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812230770 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Avril Solar" L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812230770 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

